



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.24

Prishtinë, më 16.10.2015 ora: 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama dhe Jelena Bontiq.

Munguan: Shqipe Pantina, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit: EU Office, BIRN, RTK, SPRTK, KDI, RTK2, Rrokum TV, RTK-Radio.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i propozimeve për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për RTK, nr.04/L-046;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

- 2. Shqyrtimi i propozimeve për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për RTK , nr. 04/L-046;**

Zenun Pajaziti tha se fillimi i plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për RTK-në është iniciativë e komisionit edhe pse komisioni ka pritur që kjo iniciativë të fillojë nga Qeveria. Amendamenti i ligjit do të ndryshojë nenet që kanë të bëjnë me financimin e RTK-së, por kemi edhe disa propozime që kanë të bëjnë me funksionimin e RTK-së.

Pajaziti propozoi që fillimisht të fillojë me shqyrtimin e dokumenteve të adresuara për komisionin, të cilat kanë ofruar disa mënyra dhe rekomandime lidhur me financimin e RTK-së. Ai propozoi që komisioni të mbajë një punëtori.

Alma Lama përsëriti propozimin e vet nga mbledhjet e kaluara, që për ndryshimin e Ligjit për RTK-në të procedohet njësoj sikur edhe për çështjet tjera, sipas praktikave të komisionit, do të thotë, të formohet grupi punues nga radhët e anëtarëve dhe grupin ta kryesojë ajo vet. Lama, gjithashtu kërkoi që propozimi i saj të votohet.

Xhevahire Izmaku tha se jemi dakorduar për të gjitha ligjet të cilat janë të rëndësishme së veçantë, që komisioni të punojë si grup në përbërje të plotë dhe të kryesohet nga kryetari, andaj në situata të këtilla nuk ka nevojë të formohet grup punues.

Alma Lama, në kundërshtim të diskutimit të parafolësës, tha se në disa nga mbledhjet e fundit përsëritet se Ligji për procedurën e përgjithshme administrative është një nga ligjet themelore në Kosovë, për shqyrtimin e të cilit P/ligj, komisioni ka formuar grupin punues. Në këtë kontekst ajo tha se propozimi i saj për të formuar grupin punues, të cilin ajo do ta kryesonte, është mbi bazë të njohurive që ajo ka për mediat dhe funksionimin e RTK-së.

Zenun Pajaziti propozoi që të votohet për dy propozimet:

- që komisioni të punojë në përbërje të plotë dhe
- të formohet grupi punues nga disa anëtarë të komisionit, të cilin do ta kryesonte Alma Lama.

Komisioni votoi propozimin e parë me katër vota “Për”.

Alma Lama lidhur me ndryshimet në ligj propozoi që RTK-ja për disa programe, si ato kulturore-edukative dhe dokumentare, mund të financohet nga buxheti i shtetit, por jo edhe për të gjitha. Gjithashtu, ajo tha se në fazën e hartimit të amendamenteve të merret parasysh vendimi i Gjykatës Kushtetuese, me të cilin vendim është anuluar parapagimi për RTK-në nëpërmjet faturave të rrymës.

Sadri Ferati përkrahu propozimin e znj. Alma Lama, që ligji i RTK-së të ndryshohet vetëm tek kapitulli, përkatësisht nenet për financimin e RTK-së dhe që përqindja nga buxheti për financimin e RTK-së të zvogëlohet.

Xhevahire Izmaku propozoi që përveç ndryshimeve të ligjit për nenet lidhur me financimin e RTK-së, të diskutohet edhe për ndryshimin e nenit për pronën e RTK-së.

Alma Lama kërkoi që të jetë një pasqyrë e plotë për TV-së, për arsye se hulumtimet e ofruara nuk mjaftojnë. Duhet të merren modelet e vendeve të tjera, nuk mund të merren përvojat e

transmetuesve të vendeve në regjion, të cilët kanë probleme dhe ku mediumet janë megafon i qeverisë.

Kujtim Paçaku propozoi që të ndryshohet pika e pestë e nenit të tetë, të ligjit në fuqi, përkatësisht fjala “mund” të jetë “duhet”.

Alma Lama propozoi që kanali i dytë i transmetuesit publik të mos jetë kanal vetëm për komunitetin serb, por për të gjitha komunitetet, d.m.th edhe për ato jo serbe dhe jo shqiptare.

Sadri Ferati duke përkrahur propozimin e z. Kujtim Paçaku për ndryshimin e nenit të tetë, pika pesë, ai rikujtoi të referohet sipas pikës së tretë të nenit të tetë. Ferati gjithashtu propozoi që çështja e pronës së RTK-së të tejkalohet në këtë fazë të plotësimit dhe ndryshimit të neneve për financimin e RTK-së.

Zenun Pajaziti i ftoi të gjithë aktorët, përfshirë këtu edhe Bordin e RTK-së, që të sjellin në komision propozim- ndryshimet e tyre për ligjin për RTK-në, po qe se kanë.

3. Të ndryshme.

Pasi për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime, mbledhja përfundoi.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:45.

E përgatiti :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
